REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 27, datë 17.12.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "KOMPLEKS BANIMI DHE SHËRBIMESH 5, 6, 7 KATE MBI TOKË, ME 1, 2, 3 KATE NËNTOKË" ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Open Construction" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Kompleks banimi dhe shërbimesh 5, 6, 7 kate mbi tokë, me 1, 2, 3 kate nëntokë" me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Open Construction" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE I UNIT - KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI

ANËTAR / SEKRETAR I KKT-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 13/03/ 2026